



**HULUMTIMI I MARDHËNIEVE NDËRETNIKE NË KOSOVË, DHE TË POZITËS SË
MINORITETEVE NË SHOQËRINË KOSOVARE
/STUDIM EMPIRIK /**



PRISHTINË, SHTATOR 2005

1. Arsyetimi i projektit

Kosova me dekada ka qenë një vend me tensione dhe probleme ndëretnike. Shkaqet e tensioneve të këtilla kanë qenë historike, politike, ekonomike, gjeostrategjike, demografike, arsimore, fetare e etj.

Pasoja më e rëndë e konflikteve të këtilla ka qenë Lufta e vitit 1998-99, në të cilën, në forma të ndryshme pësuan 1.000.000 njerëz.

Rreziku nga katastrofa humanitare vuri në lëvizje Bashkësinë ndërkombëtare dhe NATO-n, e cila ndërmoi veprime ushtarake për të parandaluar këtë katastrofë humanitare.

Pas përfundimit të bombardimeve të NATO-s, dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës, ndërpritën bombardimet dhe fillon kthimi i popullsisë së shpërngulur. Me vendimin e Këshillit të Sigurimit në Kosovë vendoset Administrimi Civil i Kombeve të Bashkuara, në pajtim me Rezolutën 1244.

Me tërheqjen e forcave serbe nga Kosova, tërhiqen edhe një pjesë e popullsisë joshqiptare: serbë, romë etj.

Pas luftës, ndodhin gjëra të cilat krijuan pasiguri të bashkësitë etnike joshqiptare, veçmas te minoritetit serb, romë, dhe aty këtu, edhe boshnjak. Individ të caktuar të komunitetit shqiptarë morën drejtësinë në duar të veta. U vranë njerëz të pafajshëm gra, plaka, të rinj. Kjo edhe më shumë e nxiti pasigurinë te popullsia joshqiptare, andaj shpërngulja e familjeve serbe, boshnjake dhe rome do të vazhdojë edhe gjatë vitit 1999.

Në anën tjetër dhjetëra mijëra familje shqiptare ishin në ankth të vërtetë. Kishin përjetuar tmerre monstruoze gjatë luftës, masakrime më bizare, përdhunime, djegie të kufomave. Mijëra familje nuk dinin dhe ende nuk din për anëtarët e vetë.

Urrejtja ndëretnike veçmas ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve ishte nivelin më të lartë të mundshëm.

Statusi i pazgjidhur i Kosovës, vullneti i shprehur i shqiptarëve dhe i bashkësive tjera etnike me përjashtim të serbëve për një status të pavarur të Kosovës dhe pretendimit e Serbisë që Kosovën ta mbanë me çdo kusht në kuadër të saj, kanë komplikuar gjendjen me implikime në rritjen e tensioneve ndëretnike, shtimin e ksenofobisë dhe të animoziteteve të tjera shqiptaro - serbe.

Ngjarjet e 17 dhe 18 marsit të vitit 2004 ndikuan në përkeqësimin e acaruan edhe më shumë marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Relaksimet, sa do të vogla ndëretnike që u realizuan pas vitit 1999, me këto ngjarje u flakën.

Reagimi i vendosur i Bashkësisë Ndërkombëtare dhe i Qeverisë së Kosovës në riparimin e objekteve fetare, shtëpive të shkatërruar serbe, bëri që këto marrëdhënie, edhe pse të ngrira për kohën, të kenë ndikime pozitive, që reflektoi me një kthim më të madh të familjeve serbe në shtëpitë e tyre¹.

¹ Prej 897 shtëpive të shkatërruara të regjistruara nga komisionet përkatëse, deri në shkurt të vitit 2005, janë përfunduar dhe sanuar 853 prej tyre, ndërsa në përfundim e sipër ndodhen 19 shtëpi të minoritetit serb. “..Buxheti i destinuar për meremetimin e këtyre dëmeve kap shumën prej 11 milionë eurove, për vitin 2004, nga të cilat një milion euro janë investuar nga fondi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.”...Nga 2000 euro u janë ndarë të gjitha familjeve minoritare që kanë pësuar nga trazirat. Sipas raportit të UNMIKUT del se nga 4100 pjesëtarë të pakicave që janë zhvendosur si pasojë e këtyre trazirave, deri më tani janë kthyer në shtëpitë e tyre 2400 persona, prej të

Në këtë gjendje të përgjithshme jo të favorshme ndëretnike në Kosovë ndërmjet tjerash ndikim negativ ka pasur, ka edhe do të ketë mosnjohja e gjendjes objektive të këtyre marrëdhënieve, për shkak të mungesës të studimeve të paanshme dhe me një bazament shkencor, rezultatet e të cilave do të ndihmonin në shumë plane. Ndërmjet tjerash rezultatet do të ndihmonin që procesi i edukimit dhe arsimimit të orientohet drejt vlerave siç janë: toleranca, raportet e mirëkuptimit ndërmjet bashkësive të ndryshme gjuhësore, etnike dhe fetare; luftimi i paragjykimeve, stereotipave etj. Shumë vendime që janë marrë, qoftë nga bashkësia ndërkombëtare, qoftë nga struktura e caktuara politike dhe jo politike vendim-marrëse nuk kanë arritur që të kthejnë mirëbesimin e plotë ndëretnik.

Në përkeqësimin e këtyre marrëdhënieve për fat të keq kanë ndikuar edhe sistemi i edukimit dhe arsimit i cili është përdorur si instrument për realizimin e aspiratave oligarkike, nacionaliste. Kështu, arsimit ka shpesh drejtë konflikteve të bazuara në identitetin etnik. Arsimit në vend të karakterit irenik, ka luajtur më shumë rolin e nxitësit të konflikteve të bazuara në identitetin etnik duke rritur dhe mbivlerësuar kombet e caktuara. Shpesh herë në të kaluarën, feja është përdore dhe përdoret për qëllime politike. Ka raste jo të rralla që shkollat janë shndërruar në objekte fetare, ndërsa objektet fetare në "kazerma ushtarake".

Për fat të keq të Kosovës dhe të qytetarëve të saj, hulumtime të këtyre nuk ka pasur, andaj nuk dihet saktësisht as gjendje faktike e marrëdhënieve ndëretnike, e as shkaqet e plota të cilat kanë ndikuar në këtë gjendje. Pasoja i kanë ndier në lëkurën e vetë të gjithë qytetarët e të gjitha nacionaliteteve.

Tani për tani, as politikanët, as analistët politikë, as shkencëtarët nuk kanë tregues të besueshëm për veprime të mundshme dhe optimale të cilat do të ndikonin që largësia emocionale ndërmjet bashkësive etnike, veçmas të asaj shqiptare dhe serbe të jetë më e vogël dhe më e tolerueshme. Gjithnjë flasim për nivelin e tolerancës i cili siguron një kohezion social **dhe i cili kohezion krijon karakterin miqësor për të gjithë fëmijët e Kosovës, pavarësisht nga përkatësia etnike e tyre.**

Janë këto arsye kryesore pse kemi vendosur të organizojmë një hulumtim me të cilin do të zbardhim marrëdhëniet ndëretnike, duke mëtuar të konstatojmë distancën emocionale ndërmjet bashkësive etnike, shkaqet e kësaj distance, rrugët e mundshme për dalje nga kjo situatë. Rezultatet e hulumtimit do të shërbejnë për të përcaktuar masat dhe veprimet të cilat do të inkorporohen në **Strategjinë nacionale të drejtave të fëmijës.**

2. Qëllimi hulumtimit

Hulumtimi ka për qëllim të konstatojë gjendjen objektive dhe etiologjinë e saktë të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë, mbi të cilat njohje do të merren masa gjithëpërfshirëse humane për pajtim ndëretnik, për eliminimin e paragjykimeve dhe të stereotipave etnik dhe fetar dhe mbi bazat e të cilave njohje nëpërmjet një sistemi humanist dhe demokratik ndërveprues të krijohet një shoqëri kehezive miqësore për

të gjithë fëmijët e Kosovës pavarësisht nga prejardhja etnike apo çfarëdo prejardhjeje tjetër.

3. Objektivat e hulumtimit

- ✚ Të identifikohen opinionet e bashkësive etnike që jetojnë në Kosovë për marrëdhëniet shoqërore dhe emocionale ndërmjet tyre
- ✚ Të përcaktohet dhe të identifikohet etiologjia e marrëdhënieve të tashme ndëretnike në Kosovë
- ✚ Të përcaktohet shkalla e tolerancës – jo tolerancës ndëretnike
- ✚ Të identifikohen urat e mundshme për një komunikim barabartë, human tolerantë ndërmjet dhe brenda bashkësive të ndryshme etnike dhe fetare që jetojnë në Kosovë;
- ✚ Të identifikohen opinionet e bashkësisë më të madhe etnike për të drejtat e minoriteteve dhe të vijave perspektive të minoriteteve në Kosovë
- ✚ Të identifikohen nevojat dhe dëshirat e pakicave kombëtare të vlefshme për jetë të barabartë dhe të lumtur në Kosovë

4. Hipotezat

Hipoteza e përgjithshme : Marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë janë të ngarkuara, dhe si të tilla nuk mund të jenë bazë e mirë për krijimin e një shoqërie mike për fëmijët e Kosovës

4.1. Nën- hipotezat

- a. Shumica e qytetarëve të Kosovës mendojnë se marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë janë, jo të mira dhe të pafavorshme për zhvillim normal të Kosovës
- b. Në Kosovë in toleranca etnike/ mos durimi ndëretnik/ është e lartë dhe si e tillë ajo është e pengesë për ruajtjen e paqes dhe evitimin e konflikteve
- c. Feja është faktor i rëndësishëm për përmirësimin marrëdhënieve ndëretnike .
- d. Ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në perceptimin e të ardhmes së Kosovës nga bashkësitë e ndryshme etnike që jetojnë në Kosovë dhe se bashkësia më e madhe etnike është e vetëdijshme se ajo e mbanë përgjegjësinë më të madhe për jetë të lumtur dhe të barabartë e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pavarësisht nga prejardhja e tyre.

5. Metodologjia e hulumtimit

Objekti hulumtimi do të jenë marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë. Me marrëdhëniet nënkuptojmë procesin e komunikimit, bashkëpunimit, perceptimit të ndërveprimeve ndërmjet komuniteteve etnike dhe fetare, si dhe shkallën e pranimin të bashkëjetesës dhe të fqinjësisë së mirë për një jetë të barabartë në Kosovë.

Fjala është për një Vlerësim të Shpejt që siguron informacion të saktë, të vlefshëm, të besueshëm dhe me kosto të ulët. Ky informacion do të shërbej si "provë" për *Strategji për të drejtat e fëmijës dhe për hulumtime më të thelluara.*

5.1. kampioni i hulumtimit

Objekt studimi do të jenë.

		Moshë		Gj	M	F	Islam	Ortodoks	Katolik
		14-16	Mbi 17 vjet						
1.	Shqiptarë	300	500	800	400	400	640	10	150
2.	Serbë	100	300	400	200	200	0	400	0
3.	Boshnjakë	100	200	300	150	150	300	0	0
4.	Turq	100	200	300	150	150	300	0	0
5.	RAE	50	250	300	250	50	300	0	0
	Gjithsej	650	1450	2100	1150	950	1450	410	150

Siç mund të shihet kampioni njerëzor përbëhet nga 2100 individë që do të anketohen. Prej tyre 800 shqiptarë, 400 serbë, 300 boshnjakë, 300 turq, 300 romë, ashkali dhe egjiptianë. Në aspektin gjinisë synohet që të realizohet barazia e plotë në shprehjen e opinionit. Po ashtu, do të kihet parasysh që edhe besimet fetare të përfaqësohen përafërsisht çfarë është struktura fetare në Kosovë.

Në hulumtim kemi përdorur këto modele jo- probabile:

- Modeli i mundësisë së përzgjedhjes;
- Modeli i rastësisë - aksidental
- Modeli i “ gjykimit të studiuesit”
- Modeli “ topi i borës”

Modeli i parë është modeli i mundësisë së përzgjedhjes apo i disponueshmërisë. Në hulumtim do të përfshihen personat që objektivisht kanë mundësi të përfshihen dhe dëshirojnë të përfshihen në anketim.

Krahas këtij modeli do të përdoret edhe modeli i “rastësisë: të përzgjedhjes së njerëzve në rrugë, restorante, shkolla, institucione shtetërore etj.

Njësitë hulumtuese do të përzgjidhen edhe mbi bazën e “ gjykimit të studiuesit” . Sipas këtij modeli, supozohet se studiuesi ka njohuri të mjaftueshme në lidhje me problemin hulumtimit. Kjo studiuesit i mundëson që të përzgjedhë përfaqësuesit më tipik. Fjala është përfaqësues që vlerësohet si burim i mirë i informacionit. Personat e këtillë janë informatorët vendimtarë.

Sipas modelit “topi i borës” personat e njohur sugjerojnë personat tjerë të përshtatshëm Ky cikël i kërkimit të informacionit për persona tjerë të përshtatshëm, zgjatë aq sa hulumtuesi të arrijë madhësinë e caktuar të kampionit.

5.2. Metodatat e hulumtimit

Në hulumtim do të përdoren këto metoda: deskriptive/ përshkrimi i gjendjes së marrëdhënieve ndëretnike/; kauzale/ argumentimi i shkaqeve dhe i pasojave/, historike/ shpjegimi i kontekstit/

5.3. Instrumentet e hulumtimit

Hulumtimi do të bazohet në burime primare- parësore dhe sekondare- dytësore. Burimet parësore do të jenë burimet e fituara nga anketimet, intervistat e zhvilluar dhe fokus grupet.

Burimet sekondare do të nxirren nga dokumentacioni, raportet e ndryshme. Legjislatura etj.

5.4. Zhvillimi i hulumtimit - kalendari

Nr.	Përshkrimi i aktiviteteve	Bartësit	Afati	Kostoja
1.	Hartimi i projektit të hulumtimit	H. Hyseni		
2.	Shqyrtimi i projektit të hulumtimit me trajnerët e të drejtave të fëmijës dhe OJQ	A. Hima & H. Hyseni		
3.	Përgatitja e instrumenteve të hulumtimit	H. Hyseni		
4.	Përkthimi i projektit të hulumtimit në gjuhën serbe dhe turke	H Hyseni		
5.	Përgatitja ekipit për hulumtimi	H. Hyseni		
6.	Organizimi i hulumtimit në terren	G. punuese		
7.	Diskutim në tri fokuse grupe	Halim Hyseni		
7.	Përpunimi statistikor i të dhënave	G. punuese		
8.	Përpunimi dhe interpretimi i të dhënave	Grupet punuese		
9.	Përmbledhja e separatëve në një material të përbashkët dhe shkrimi i raportit-përgatitja për botim	H.Hyseni		
10	Botimi i rezultateve të hulumtimit	H.Hyseni& G.Krasniqi		

Shtojcë:

I. Ekipi hulumtues:

Udhëheqës i hulumtimit : Halim Hyseni

Ndihmës udhëheqësi: Ardita Hima & Gëzim Krasniqi

Trajnerët për të drejtat e njeriut

II. Bateria e instrumenteve

Instrumenti për mbledhjen dhe tubimin e të dhënave përbëhet nga një bateri të instrumenteve

a. SHTESA 1. PYETËSOR PËR STUDIMIN E MARRËDHËNIVE NDËRETNIKE NË KOSOVË

UDHËZIM PËR PLOTËSIM

Ne jemi të bindur se secili qytetar i Kosovës pavarësisht nga përkatësia etnike, fetare, gjinore, mosha, shtresa sociale etj., është i interesuar që në Kosovë të jetojë i lumtur, i lirë, i barabartë me të gjithë të tjerët para ligjit. Po ashtu, jemi të bindur se secili qytetarë është i interesuar që në Kosovë të ekzistojë një klimë e tolerancës, mirëkuptimit, miqësisë dhe të solidaritetit qytetar në mënyrë që të krijohet një ambient miqësor për fëmijët tanë që ata të rriten pa frikë, pa kërcënime, pa presione, në një sistem demokratik dhe të avancuar të arsimit. Ne, për çdo ditë dëgjojmë vlerësime më të ndryshme për marrëdhëniet ndëretnike, për lëvizjen e lirë, për drejtësinë, për arsimin etj, por askush deri më tani nuk ka tregues të cilit me shkallë të lartë objektivitetit do të tregonte gjendjen reale. Mosnjohja e gjendjes reale vështirëson, apo më saktësisht thënë pamundëson një vendimmarrje a një politikë-bërje funksionale e cila do të shndërrohej në një strategji produktive të krijimit marrëdhënive të miqësisë, solidaritetit, mirëkuptimit ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike, fetare, gjinore, ndërpartiake dhe ndërinstytucionale.

Për këtë qëllim është përpiluar edhe ky pyetësor me elemente të shkallës së vlerësimit.

Instrumenti është anonim, kështu që nuk mund të keni asnjë pasojë për shkak mendimeve tuaja të shprehura. Luteni që plotësimin ta bëni me shkrim të lexueshëm dhe në përputhje me kërkesat e shtruara.

Duke shprehur në përgjigje tuaja të sinqerta, ju shprehim falënderimet tona më të ngrohta.

I-1. MOSHA E JUAJ:

I-2 . PËRKATËSIA E JUAJ ETNIKE ?

I -2	Ju jeni?	
I-22	Shqiptar	1
I-23	Serb	2
I-24	Boshnjak	3
I-25	Turk	4
I-26	Rom	5
I-27	Ashkali	6
I-28	Egjiptian	7
I-29	Diçka tjetër	8

1.3. PËRAKTËSIA E JUAJ FETARE?

I-3	Cila është feja – besimi i juaj ?	
I-31	Islame	1
I-32	Katolike	2
I-33	Ortodokse	3
I-34		4

1.4. SHKALLA E PRANIMIT TË FESË ?

I-4 . Shkalla e miratimit të besimit : 1 E pranoj 2 Nuk e pranoj 3 Nuk e di

I- 41. Islamin	1	2	3
I- 42. Katolik	1	2	3
I- 43. Ortodoks	1	2	3
I- 44. _____	1	2	4

1.5. GJUHA TË CILLËN E PËRDORNI NË FAMILJE ?

I- 5	Në shtëpi Ju e flisni gjuhën	
I-51	Shqipe	1
I-52	Serbe	2
I-53	Boshnjake	3
I-54	Turke	4
I-55	Rome	5
I-56		

1.6. SHKALLA E JUAJ E ARSIMIMIT?

I- 6	Niveli i arsimimit tuaj	
I-61	Pa shkollë fillore	1
I-62	Arsimimi fillor katër klasë	2
I-63	Arsimi fillor tetëvjeçar	3
I-64	Arsimi i mesëm i ulët – arsim 9 vjeçar	4
I-65	Arsimimi i ulët i mesëm	5
I-66	Arsimimi i mesëm trevjeçar	6
I-67	Arsimimi i mesëm katërvjeçar	7

I-68	Arsimimi i lartë dyvjeçar	8
I-69	Arsimi i lartë trevjeçar	9
I-69.1	Arsimi i lartë katër e më shumëvjeçar	10

1.7. PËRKATËSIA GJINORE

I - 7	Gjinia	
I-71	Femërore	1
I-72	Mashkullore	2

II

II-1. SI I VLERËSONI MARRËDHËNIET NDËRETNIKE NË KOSOVË?

Si e vlerësoni marrëdhëniet ndëretnike	Si i vlerësoni marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë(marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve e serbëve; shqiptarëve e boshnjakëve; shqiptarëve e turqve; shqiptarëve e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve; marrëdhëniet ndërmjet serbëve, boshnjakëve, turqve, romëve, ashkalinjve e egjiptianëve; marrëdhëniet ndërmjet boshnjakëve , turqve, romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve; marrëdhëniet ndërmjet , turqve, romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve					
Shkallët e vlerësimit	Për vlerësim i përdorni këto shkallë: - marrëdhëniet shumë të mira, vlerësohen me notën (5) - marrëdhëniet e mira, vlerësohen me notën..... (4) - marrëdhëniet jo të mira vlerësohen me notën (3) - marrëdhëniet shumë të këqija, vlerësohen me notën..... (2) - mungesa e opinionit tuaj që shprehet me : “ nuk di “ shënohet me (1)					
	Ju lutemi përgjigjuni për çdo rresht					
		5	4	3	2	1
II- 12	Marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve	5	4	3	2	1
II- 13	Marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe boshnjakëve	5	4	3	2	1
II- 14	Marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe turqve	5	4	3	2	1
II- 15	Marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve	5	4	3	2	1
II- 16	Marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe boshnjakëve	5	4	3	2	1
II- 17	Marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe turqve	5	4	3	2	1
II- 18	Marrëdhëniet ndërmjet serbëve, romëve dhe egjiptianëve	5	4	3	2	1
II- 19	Marrëdhëniet ndërmjet boshnjakëve dhe turqve	5	4	3	2	1
II- 19.1	Marrëdhëniet ndërmjet boshnjakeve dhe romëve, ashkalinjve, dhe egjiptianëve	5	4	3	2	1
II- 19.2	Marrëdhëniet ndërmjet turqve dhe romëve					

	JU LUTEM përgjigjuni në çdo rresht		
	A pajtoheni ?	PO	JO
II-22	Të martoheni me shqiptar – e		
II-23	Të shoqëroheni me shqiptarë		
II-24	T' a keni fqinj shqiptarin		
II-25	Të punoni me shqiptarë		
II- 26	Të jetoni në të njëjtin vend me shqiptarë		
II- 27	Të jetoni në të njëjtin shtet me shqiptarë		

II-2. KUJDES: Në pyetje në tabelën vijuese përgjigjen vetëm ata që veten nuk e konsiderojnë shqiptarë

II-3	JU LUTEM përgjigjuni në çdo rresht		
	A pajtoheni ?	PO	JO
II-31	Të martoheni me serb/serbe		
II-32	Të shoqëroheni me serbe		
II-33	T' a keni fqinj serbin		
II-34	Të punoni me serbin		
II-35	Të jetoni në të njëjtin vend me serbin		
II-36	Të jetoni në të njëjtin shtet me serbin		

II-3. KUJDES: Në pyetje në tabelën vijuese përgjigjen vetëm ata që veten nuk e konsiderojnë serbë

II-4	JU LUTEM përgjigjuni në çdo rresht		
	A pajtoheni ?	PO	JO
II-41	Të martoheni me boshnjak/boshnjake		
II-42	Të shoqëroheni me boshnjak		

II-4 KUJDES: Në tabelën vijuese përgjigjen vetëm ata që veten nuk e konsiderojnë boshnjak

II-43	T' a keni fqinj boshnjakun		
II-44	Të punoni me boshnjakun		
II-45	Të jetoni në të njëjtin vend me boshnjakun		
II-46	Të jetoni në të njëjtin shtet me boshnjakun		

II-5	JU LUTEM përgjigjuni në çdo rresht		
	A pajtoheni ?	PO	JO
II-51	Të martoheni me rom, ashkalinj apo egjiptian		
II-52	Të shoqëroheni me rom, shkali apo egjiptian		
II-53	T' a keni romin, shkalin apo egjiptianin		
II-54	Të punoni me romin, shkalin apo egjiptianin		
II-55	Të jetoni në të njëjtin vend me romin, shkalin apo egjiptianin		
II-56	Të jetoni në të njëjtin shtet romin shkalin egjiptianin		

II-5. KUJDES: Në pyetje në tabelën vijuese përgjigjen vetëm ata që veten nuk e konsiderojnë rom, shkali, dhe egjiptian

III-1. A do të kishit pranuar që mësuesi i fëmijës tuaj t' ishte?

	Ju lutem përgjigjuni në çdo rresht			
		PO	JO	Nuk e di
III- 11	Shqiptar			
III - 12	Serb			
III – 13	Boshnjak			
III -14	Turk			
III -15	Rom, ashkali ose egjiptian			

III-2. A do të kishit pranuar që shefi i shërbimit policor në Kosovë t' ishte?

	Ju lutem përgjigjuni në çdo rresht			
		PO	JO	Nuk e di
III- 21	Shqiptar			
III – 22	Serb			
III - 23	Boshnjak			
III - 24	Turk			
III - 25	Rom, ashkali ose egjiptian			

III-3 A do të kishit pranuar që komandant i Trupave Mbrojtëse të Kosovës t' ishte ?

III-3	Ju lutem përgjigjuni në çdo rresht			
		PO	JO	Nuk e di
III- 31	Shqiptar			

III – 32	Serb			
III – 33	Boshnjak			
III - 34	Turk			
III -35	Rom, ashkali ose egjiptian			

Ju lutem përgjigjuni në çdo rresht

III-4 A do të kishit pranuar që kryeministri i Kosovës t' ishte ?

Ju lutem përgjigjuni në çdo rresht				
		PO	JO	Nuk e di
III- 41	Shqiptar			
III –42	Serb			
III – 43	Boshnjak			
III -44	Turk			
III - 45	Rom, ashkali ose egjiptian			

III-5. A pajtoheni që numri i nxënësve romë, ashkali dhe egjiptian në klasën e fëmijës tuaj të jenë:

Ju lutem përgjigjuni në çdo rresht				
		PO	JO	Nuk e di
III- 51	Disa nxënës			
III –52	Gjysma e nxënësve të jenë romë			
III –53	Shumica e nxënësve të jenë romë			

IV. Ekzistojnë mendime të ndryshme rreth të drejtave të minoriteteve. A mendoni se minoritetet në Kosovë i gëzojnë këto të drejta ?

		PO	JO	Nuk e di
IV-11	Të themelojnë organizata dhe asociacione për ruajtjen e kulturës së tyre			
IV-12	Të publikojnë libra në gjuhën e tyre amtare			
IV-13	Të arsimohen në gjuhën e tyre amtare			
IV-14	T'i kenë përfaqësuesit e tyre në Parlament			
IV -15	T'i kenë përfaqësuesit e tyre në qeveritë lokale			
IV-16	Të kenë të drejtën që emërtimet e vendbanimeve t'i quajnë në gjuhën e tyre amtare			
IV-17	Të kenë parti politike			
IV-18	Të kenë media elektronike në gjuhën amtare			
VIII- 19	Të jenë të përfaqësuar në TMK dhe SHPK			
VIII- 19.1	Të kenë emisione në gjuhën e tyre amtare në televizionin publik			
IV-19.2	Të kenë gazeta dhe revista në gjuhën e tyre			

	amtare			
IV –19.3	Të jenë të mbrojtur me ligj të veçantë			

V. A pajtoheni me këto qëndrime?

Pajtimin e shprehni me këto shkallë:

Plotësisht pajtohem	1
Pajtohem	2
Nuk pajtohem.....	3
Fare nuk pajtohem.....	4

	Përgjigjuni rresht për rresht	1	2	3	4	5
V-51	Shqiptarët janë të favorizuar krahasuar me bashkësitë tjera etnike	1	2	3	4	5
V-52	Shqiptarët tentojnë të kenë pozita të larta udhëheqëse	1	2	3	4	5
V-53	Shqiptarët janë besimtarë fanatik	1	2	3	4	5
V-54	Shqiptarëve nuk u besohet	1	2	3	4	5
V-55	Shqiptarët janë servil ndaj UNMIK-ut					
V-55	Shqiptarët duhet shpërngulur nga Kosova	1	2	3	4	5
	Nuk e di.....					5

V-1. Ata të cilit veten e konsiderojnë shqiptarë, nuk duhet të përgjigjen në këtë pyetje.

V-2 KUJDES: Ata që veten e konsiderojnë serb nuk përgjigjen në këto pyetje

		1	2	3	4	5
V-2						
V-21	Serbët janë të favorizuar krahasuar me bashkësitë tjera etnike	1	2	3	4	5
V-22	Serbët tentojnë të kenë pozita të larta udhëheqëse	1	2	3	4	5
V-23	Serbët janë besimtarë fanatik	1	2	3	4	5
V-24	Serbëve nuk u besohet	1	2	3	4	5
V-25	Serbët janë servil ndaj serbëve	1	2	3	4	5
IX -89	Serbët duhet të shpërngulen në Serbi	1	2	3	4	5

V-3. KUJDES: Ata të cilit veten e konsiderojnë boshnjak nuk përgjigjen në këtë pyetje

Përgjigjuni rresht për rresht

		1	2	3	4	5
V-3						
V-31	Boshnjakët janë të favorizuar krahasuar me bashkësitë tjera etnike	1	2	3	4	5
V-32	Boshnjakët tentojnë të kenë pozita të larta	1	2	3	4	5

	udhëheqëse					
V-33	Boshnjakët janë besimtarë fanatik	1	2	3	4	5
V-34	Boshnjakëve nuk u besohet	1	2	3	4	5
V-35	Boshnjakët duhet të shpërngulen në Serbi	1	2	3	4	5

V-4. KUJDES: Ata të cilit veten e konsiderojnë turk në këtë pyetje nuk përgjigjen

Përgjigjuni rresht për rresht

V-4		1	2	3	4	5
V-41	Turqit janë të favorizuar krahasuar me bashkësitë tjera etnike	1	2	3	4	5
V-42	Turqit tentojnë të kenë pozita të larta udhëheqëse	1	2	3	4	5
V-42	Turqit janë besimtarë fanatik	1	2	3	4	5
V-43	Turqit nuk u besohet	1	2	3	4	5
V-44	Turqit janë servil ndaj shqiptarëve	1	2	3	4	5
V-45	Turqit duhet bërë përpjekje të shpërngulen në Bosnje a në Novi Pazar	1	2	3	4	5

V-5 Ata të cili veten e konsiderojnë rom , ashakali dhe apo egjiptian nuk përgjigjen në këtë pyetje.

Përgjigjuni rresht për rresht

V-5		1	2	3	4	5
V-51	Romët, ashkalintë dhe egjiptianët janë të favorizuar krahasuar me bashkësitë tjera etnike	1	2	3	4	5
V- 52	RAE tentojnë të kenë pozita të larta udhëheqëse	1	2	3	4	5
V- 53	Turqit janë besimtarë fanatik	1	2	3	4	5
V- 54	Turqve nuk u besohet	1	2	3	4	5
V- 53	Turqit janë servil ndaj shqiptarëve	1	2	3	4	5
V-54	Turqit duhet bërë përpjekje për t'i shpërngul për Turqi	1	2	3	4	5

V-6. Me të cilit anëtarë të bashkësive etnike nuk do të kishe dëshiruar të ndash dhomën

e fjetjes:

- a. Shqiptar
- b. Serb
- c. Boshnjak
- d. Turk
- e. Rom
- f. Ashkali
- g. Egjiptian

V_7. Çka mendoni a ka bashkësi etnike në Kosovë, të cilat veten e konsiderojnë si më “superiore” më të avancuar në aspektin e zhvillimi tkulturor dhe akademik

a. PO 1 JO 2

V-71. Nëse jeni përgjigjur me “PO” shënoni emrin e bashkësisë etnike të cilin e konsideroni superiore _____

V-72. Lëvizja e lirë e qytetarëve është një ndër të drejtat e themelore të njeriut. Çka mendoni a ekziston në Kosovë e LËVIZJA E LIRË për të gjithë qytetarët

a. PO 1 JO 2

V-73. Nëse jeni përgjigjur me “JO “, ju lutem tregoni se qytetarët e të cilës bashkësi etnike nuk gëzojnë të drejtën e lëvizjes së lirë _____

B. PYETJET PARAPRAKE PËR MËSUESË , ANËTARË TË BASHKËSIVE TË NDRYSHME ETNIKE, KLERIK - PËRFAQËSUES TE FEVE QË VEPROJNË NË KOSOVË- TË OJQ-VE

/ Të gjithë përgjigjen në të gjitha pyetjet /

1. Si i cilësoni ju marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë?
2. A mendoni se në Kosovë ka bashkësi etnike të favorizuara? Cilat janë ato? Pse mendoni se janë të favorizuara?. Jepeni ndonjë argument!
3. Cilat bashkësi etnike, mendoni se nuk i gëzojnë të drejtat etnike? Në të cilat fusha? Cilat janë shkaqet që kanë ndikuar që këto bashkësi etnike në Kosovë të mos i gëzojnë të drejtat e barabarta? Çfarë duhet bërë sipas jush që të përmirësohen marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë?
4. Çka mendoni për barazinë fetare në Kosove? A ka tolerancë dhe mirëkuptim ndër - fetar? Cila bashkësi fetare është e favorizuar? Si e shpjegoni ju këtë favorizim? Çfarë duhet bërë që të zhvillohem mirëkuptimi dhe toleranca ndër fetare në Kosove?
5. Si e vlerësoni lirinë e lëvizjes në Kosovë? Cilat bashkësi etnike nuk e gëzojnë lëvizjen e lirë . Pse?
6. Çfarë ka bërë organizata- bashkësia a komuniteti i juaj që të përmirësohen raportet ndër - etnike dhe ndër - fetare në Kosovë?
7. Ç’ rekomandime sugjeroni për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe ndër – fetare në Kosovë